



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 334, Datë 19.12.2022

MBI  
MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ATEANI  
ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/1 prot., datë 14.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2036 prot., datë 05.12.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1.1 gërmat “a”, “b”, “c”.  
**Plotësuar;**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 1.2, gërmat “a”, “d”.  
**Plotësuar;**
  - Pika 2.5. Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike.  
**Plotësuar.**
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

#### NENI 9

#### Formati dhe dokumentacioni për aplikim

#### Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
- **gërma “b”:** Shoqëria nuk ka depozituar në ERE Vërtetimet e Gjendjes Gjyqësore për shoqërinë si edhe për administratorin.
- **gërma “c”:** Shoqëria ka depozituar në ERE strukturën organizative të saj, por nuk ka përcjellë informacion lidhur me stafin përkatës i cili do të jetë në funksion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
- **gërma “a”:** Shoqëria nuk ka depozituar në ERE Vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”:** Në vijim të depozitimit të informacionit të sipër përmendur shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k., nuk ka deklaruar në asnjë moment se me çfarë fondesh do të mbulojë veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Në kushtet kur kjo shoqëri është e përbërë nga dy ortakë, vlerësohet se duhet të përcaktonte me anë të vendimit të asamblesë se cili nga ortakët do të ndërmarrë mbulimin financiar.
- **gërma “c”:** Shoqëria nuk ka përcjellë plan biznesi për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në kuptim të kësaj kërkesë të rregullores.

- **Po ashtu evidentohet se shoqëria nuk ka të parashikuar në objektin e saj në QKB, ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.**
- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**